

Lehrplan Volksschule Kanton St.Gallen



Çfarë vlen tani?

Kanton St.Gallen
Bildungsdepartement



Të dashur prindër

A e dini ende, çfarë keni mësuar në shkollë? Si është kjo tek fëmija juaj? Çfarë ai duhet të dijë dhe të jetë në gjendje të bëjë në fund të kohës shkollore, kjo shkruhet në planin mësimor.

Nga që shumë gjëra ndryshojnë, plani mësimor i Shkollës Popullore aktualizohet herë pas here. Gjëra të reja – për shembull puna me kompjuterin – duhen mësuar. Prandaj që nga ky vit shkollor ekziston një plan i ri mësimor. Fëmija juaj duhet të mësojë këto gjëra, të cilat i duhen atij për një hyrje të suksesshme në botë profesionale ose në një shkollë të mëtejshme.

Përmes bashkëpunimit të suksesshëm midis prindërve, shkollave dhe autoriteteve, fëmijët dhe adoleshentët në kantonin St.Gallen marrin një arsimim optimal.

« Me planin mësimor të Shkollës Popullore, fëmijët tanë aftësohen për t'u marrë në mënyrë të suksesshme me kërkesat e shoqërisë së sotme »

Mirë të dish

Shumë gjëra, të cilat i mësuan fëmijët dhe adoleshentët deri tani, do të jepet edhe më tej në mësim. Ende ato janë të drejta dhe të rëndësishme. Por do të ketë edhe disa ndryshime:

- **Lëndët:** Shtohen lëndë të reja ose ato marrin një emërtim të ri. Që nga klasa e 5-të primare, fëmija juaj për shembull merr pjesë në lëndën e re «Medien und Informatik» (mediet dhe informatika).
- **Të shkruarit në mësimdhënie:** Fëmija juaj mëson tanimë përmes «Deutschschweizer Basisschrift» (shkrimi bazë gjermano-zviceran) shkrimin e tij personal të dorës dhe jo më përmes shkrimit të shtypit dhe shkrimit të dorës «Schnürlischrift». Veç kësaj, që nga klasa e 3-të primare ai fiton përvoja me shkrimin në tastierë të kompjuterit.

- **Detyrat e shtëpisë:** Me anë të detyrave të shtëpisë, fëmija juaj e ushtron mësimin e shkollës në shtëpi. Ato janë si një dritare për në shkollë dhe ato ju mundësojnë juve një shikim drejt orëve të mësimin të fëmijës suaj. Në shkollë primare, nga e premtja deri të hënën nuk jepen më detyra shtëpie.
- **Dëftesa:** Dosja dhe formularët e dëftesave janë krijuar në mënyrë të re. Që nga fundi i klasës së 2-të primare, fëmija juaj e merr një dëftesë notash si përfundim të çdo semestri. Veç kësaj, mësuesi ju fton çdo vit për një bisedë vlerësimi.

Shikim në planin mësimor

Në fillim të kohës shkollore - në kopshtin e fëmijëve - fëmija juaj mëson me anë të lojërave dhe përtej kufijve të lëndëve. Në shkollë primare dhe në cikël të lartë, programi shkollor është i ndarë në disa fusha të specializuara.

1. Zyklus KG und 1./2. Klasse Primarschule	2. Zyklus 3. – 6. Klasse Primarschule	3. Zyklus 1. – 3. Oberstufe
Deutsch		
Englisch		
Französisch		
Mathematik		
Natur, Mensch, Gesellschaft		Natur und Technik
		Wirtschaft, Arbeit, Haushalt
		Räume, Zeiten, Gesellschaften
		Ethik, Religionen, Gemeinschaft Schule Ethik, Religionen, Gemeinschaft Kirchen
Gestalten (Bildnerisches Gestalten / Textiles und Technisches Gestalten)		
Musik		
Bewegung und Sport		
Medien und Informatik		
Berufliche Orientierung		

Në çfarë ore në secilën ditë të javës fëmija juaj duhet të jetë në shkollë, kjo mund të lexohet në orarin e mësimave. Këtë e merrni nga shkolla e fëmijës suaj.

Kështu mëson fëmija juaj

Fëmija juaj në shkollë njihet me tema të ndryshme dhe e zgjeron dijen e vet. Ai mëson aftësi dhe zotësi të ndryshme si për shembull të shkruarit dhe të llogariturit.

Fëmija juaj inkurajohet ta vë të mësuarin në punë. Klasa shkollore për shembull merret me motin. Gjatë planifikimit të ekskursionit shkollor, nxënëset dhe nxënësit mund të aplikojnë këtë dije direkt duke vështruar, në cilën ditë parashikohet moti më i mirë për këtë.

Duke e futur të mësuarin shpesh në punë, fëmija juaj fiton siguri dhe merret me dijen e vet me një siguri në vetvete. Nëse ai merret me një temë të re, ai nxjerr fitime nga aftësitë, të cilat ai tashme zotëron. Fëmija juaj bëhet kompetent.

Mësuesit i përkrahin fëmijët dhe adoleshentët gjatë mësimdhënies në mënyra të ndryshme. Për këtë ata shfrytëzojnë mjete të përshtatshme mësimi. Me një raport të mirë ndaj fëmijës dhe me diturinë e tyre të specializuar, ata e bëjnë të mundur, që nxënëset dhe nxënësit mësojnë me gëzim dhe motivim.

« Në të mësuarit, ajo që u mësua më parë merret si pikënisje dhe zhvillohet më tej »

Informata të mëtejshme

- Nëse keni pyetje, ju mund t'iu bëni ato mësuesve të fëmijës suaj.
- Më shumë informata rreth planit mësimor të Shkollës Popullore gjeni gjithashtu tek www.lehrplan.sg.ch